

## FJALIM- JULIEN ROCHE

### SHKOLLA E VERËS

“Sipërmarrja franko-shqiptare sot dhe nesër”

**Përshëndetje të nderuar studentë dhe studente,  
I nderuar Profesor, Doktor Z. Artur Sula  
Të nderuar profesorë dhe te ftuar...**

Ky është takimi i 4-të frankofon që organizojmë me ju, të dashur studentë, dhe çdo vit e më shumë me jep energji takimi me ju. Është shumë stimuluese të gjëndem dhe të reflektoj sëbashku me ju rreth një teme të caktuar. *Tema mbi të cilën do të flasim këtë vit është mbi Sipërmarrjen franko-shqiptare sot dhe nesër.*

Po ju tregoj pak histori mbi sipërmarrjen – **KONCEPTE FRANCEZE**

« Franca ka një vend të caktuar në historinë e sipërmarrjes për të paktën dy arsye :

- E para është koncepti i një kompanie aksionare, hapi vendimtar, i cili ka lindur më 1372 në Toulouse me krijimin e kompanisë Moulins du Bazacle. Ndërmarrja moderne nuk lindi në Itali në shekullin e 15-të, me paraqitjen e bankave të mëdha, as në Angli dhe Holandë në fillim të 17-të, me krijimin e kompanive të mëdha tregtare, por lindi në brigjet e Garonne, ne France.
- Kontributi i dytë i Francës është vetë fjala *Ndërmarrës*, i cili perkufizonte disa oficerë ushtarakë të ushtrisë franceze nga shekulli i 17-të. Do t'i dedikohet shekullit të 18-të nga ekonomistët e parë francezë (si Jean-Baptiste Say ose Etienne Bonnot de Condillac) ose ekonomistëve (si Richard Cantillon) »

Unë gjithashtu do t'ju shpjegoj krijimin e "Dhomës së Tregtisë Francë-Shqipëri". Ishte një ide e përbashkët që kam pasur me Hubert de Saint Jean, i cili në atë kohë ishte drejtori i bankës Societe Generale. Vitin e pare ne kishim statusin e Klubit të Biznesit, duke bashkuar të gjitha kompanitë franceze dhe shqiptare. Në vitin 2013 u njohëm si Dhomë Tregtie nga Parisi.

Sot, ne numërojmë rreth 80 anëtarë, kompani shqiptare dhe franceze, si Societe Generale Albania, Safran Group, Selenice Bitumi, Spiecapag, Safrecom, Renault, Citroen, Peugeot, Total, Eutelsat dhe shumë të tjera.

Siç jua ka shpjeguar dhe Blerina gjatë konferencës që u zhvillua para dy javëve,

- Jeni të gjithë të ftuar të na dërgoni CV-të tuaja dhe ne do t'ua shpërndajmë anëtarëve tanë
- Ju sygjeroj gjithashtu të kontaktoni direkt kompanitë franceze ose frankofone për punë me kohë të plotë ose stazhe të ndryshme.
- Ose, nëse ju dëshironi të filloni një biznes, Dhoma jonë ju ofron shume informacione praktike për t'ju ardhur në ndihmë rreth projektit tuaj.

Sepse, të dashur studentë, për të ndërmarrë sfidën e së ardhmes, për t'u bërë udhëheqës të së nesërmes, siç ka thënë Confucius. ***Ju nuk do të gjeni kurrë atë që nuk e kerkoni.***

Gjithashtu, do t'u sugjeroja përgjegjësve të universitetit që më shumë se kurrë, shkolla duhet të hapi kufinj të, të ftojë të rinjtë të ndërmerren me projekte të ndryshme jashtë vendit. Duhet të përgjithësohen iniciativat e tipit Erasmus, duke dërguar sistematikisht studentët në stazhe ose kurse në mjedise të ndryshme nga ato në të cilat ata janë mësuar.

**Të dashur studentë, e Nesërmja është afër dhe e ardhmja e të rinjve shqiptar, është në Shqipëri !**

Dua t'ju bëj me dije të gjithëve - studentët, profesorët, franko-shqiptarët, që Dhoma Franceze është ketu për t'ju mbështetur në hapat tuaja, mos hezitoni te me kontaktoni personalisht.

**Kënaqësi t'ju ritakoj sërish vitin e ardhshëm dhe ju uroj shumë suksese në studimet tuaja!**

Ju faleminderit !

Julien Roche  
Kryetar